




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit

Nr. 04 - 611/01-17336/22

Datë, 24.06.2022

Në bazë të Ligjit nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit shpallë:

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Gjimnaz dhe Shkollën Profesionale për vitin shkollor **2022/2023**

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor **2022/23**, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto

dokumente:

- Fletëparaqitja (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

Sqarim: Shkolla duhet të krijoj kushte për mbajtjen e distancës së nxënësve gjatë aplikimit të tyre.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaz dhe IAP për vitin shkollor **2022/2023**, bëhet më datën **27, 28 dhe 29 qershor 2022**, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **08.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **30.06.2022**. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **01 korrik 2022**. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - Komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | | |
|---|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) | 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) | 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) | 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%) 100 pikë.

Shih: Vendimin e MASHTI të datës 16.06.2022, për kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, për vitin shkollor 2022-2023

IAAP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" - Kaçanik

Nr.	DREJTIMI	PROFILI	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve
1.	ELEKTROTEKNIKË	- Elektronikë industriale - Informatikë - Instalues elektrik	1	24
2.	EKONOMI	- Nëpunës i shpëdicionit dhe logjistikës - Tregti me shumicë dhe pakicë - Kontabilitet dhe tatime	1	24
3.	MAKINERI	- Instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit dhe kanalizimit - Operator i trafikut rrugor - Automekanik - Metalpunues	2	48
4.		Gjithsej	11	264

Gjimnazi “ Skënderbeu” - Kaçanik

Nr.	DREJTIMI	Nr. i paraleleve	Nr.inxënësve
1.	Shkenca Natyrore	4	128
2.	Shkenca Shoqërore-Gjuhësore	4	128
	Gjithsej	8	256

Drejtori i DASHKUT
Z. Zahir Doda

